

**Raporti i vlerësimit të cilësisë nga studentët
për vitin akademik 2020/2021
Programi: Menaxhment i Hotelierisë dhe Turizmit**

1. Hyrja

Në këtë raport janë paraqitur vlerësimet e programit dhe të stafit akademik nga studentët e programit Menaxhment i Hotelierisë dhe Turizmit.

Vlerësimi i programit është realizuar përmes pyetësorit për vlerësim të programit të vendosur në Sistemin e Menaxhimit Universitar (SMU), i cili përmbanë 21 komponente. Mënyra e grybullimit të të dhënave këtë vit ka kaluar nga forma manuale në atë elektronike. Pyetësi i vlerësimit të programit ka ndryshuar. Ky vlerësim realizohet një herë brenda një viti akademik dhe vlerësimi bëhet nga studentët e këtij programi. Pyetjet e vlerësimit të programit janë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likertit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3- pajtohem pjesërisht; 4-pajtohem; dhe 5-pajtohem plotësisht).

Vlerësimi i stafit akademik është realizuar gjithashtu përmes pyetësorit të vendosur në Sistemin e Menaxhimit Universitar (SMU). Për dallim nga vlerësimi i programit, i cili realizohet një herë brenda një viti akademik, vlerësimi i stafit akademik realizohet në çdo semestër. Forma e grybullimit të të dhënave edhe te ky vlerësim, këtë vit akademik është realizuar në formë elektronike. Pyetjet edhe te ky vlerësim janë të ndërtuara në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likertit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3- pajtohem pjesërisht; 4-pajtohem; dhe 5- pajtohem plotësisht).

1.1 Raporti i vlerësimit të Programit nga studentët për vitin akademik 2020/2021

Bazuar në rezultatet e vlerësimit të programit, të paraqitura në tabelën nr.1, vërejmë se shumica e komponenteve të këtij sesi janë vlerësuar pozitivisht nga studentët. Vlenë të theksohet se

bazuar në rezultatet e këtij vlerësimi, komponenti që nuk është vlerësuar kënaqshëm nga studentët është puna praktike jashtë institucionit, por duke pasë parasysh që në këtë vit akademik mësimi është realizuar online për shkak të kufizimeve të pandemisë, rezultati i tillë ka qenë i pritshëm. Gjithashtu, menaxhmenti i këtij Fakulteti duhet t'u kushtojë rëndësi të gjitha komponenteve, të cilat janë vlerësuar nën 4. Në fokus më të theksuar për përmirësim mbeten komponentet të cilat janë vlerësuar nën 3.5, që përfshinë rreth 53% të komponenteve nga vlerësimi i prezantuar në tabelën nr.1. Marrë në përgjithësi, kënaqshmëria e studentëve me programin këtë vit akademik është 69% ose 3.4.

Tabela nr.1 Vlerësimi i programit

Nr.	Pyetjet vlerësuese	Mesatarja e vlerësimit
1	Materialet e prezantuara gjatë ligjëratave iu ofrohen studentëve rregullisht	3.80
2	Literatura e sugjeruar për lëndët na bëhet e ditur që në fillim të semestrit	3.89
3	Syllabuset e lëndëve iu ofrohen me kohë studentëve	3.88
4	Studentët janë të njoftuar me orarin e konsultimeve të mësimdhënësve	3.42
5	Orari i konsultimeve me mësimdhënësit respektohet	3.24
6	Që në fillim jemi të njoftuar me mënyrën më të mirë të arritjes së rezultateve të mësimnxënies	3.55
7	Metodat e mësimdhënies ofrojnë mënyrën më të mirë të arritjes së rezultateve të mësimnxënies	3.70
8	Mësimi online (përmes Microsoft Teams) nuk dallon shumë nga ai në klasë	3.03
9	Sistemi i Menaxhimit Universitar (SMU) është i lehtë për dhe i plotëson nevojat e studentëve	3.07
10	Sallat e mësimi janë të pajisura mirë me mjete audio-vizuele për mësim cilësor	3.24
11	Egziston një lidhje e mirë e mësimi teorik dhe atij praktik	3.26
12	Studenti është i lirë që vetë të përcaktohet për lëndët zgjedhore	3.68
13	Orari i mësimi shpallet me kohë	3.68
14	Orari i shpallur i mësimi respektohet nga mësimdhënësit	3.55
15	Programi i studimit është në përputhje me nevojat e tregut të punës	3.32
16	Programi i studimit është i krahasueshëm me programet e ngjashme në universitetet tjera	3.34

17	Angazhimi i studentit në lëndë është i balancuar (nuk është i mbingarkuar)	3.21
18	Puna praktike jashtë insitucionit organizohet mirë nga universiteti	2.90
19	Mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve janë të njohura për	3.35
20	Mendimi im i përgjithshëm për këtë program të studimit është pozitiv	3.63
21	Këtë program të studimit do t'ia sugjeroja edhe personave të tjerë	3.58

1.2 Raporti komulativ i vlerësimit të stafit akademik për programin BSc. Menaxhment i Hotelierisë dhe Turizmit për vitin akademik 2020/2021

Stafi akademik i programit Menaxhment i Hotelierisë dhe Turizmit është vlerësuar në çdo semester dhe në tabelën nr .2 janë paraqitur rezultatet komulative të vlerësimit për secilin komponent. Bazuar në rezultatet e vlerësimit të stafit akademik, vërejmë se të gjitha komponentet e këtij sesioni janë vlerësuar pozitivisht nga studentët ose më saktësisht mbi 4. Gjithashtu, menaxhmenti i këtij Fakulteti duhet të mbetet i përkushtuar që të përmirësojë edhe më tutje kënaqshmërinë e studentëve me stafin akademik. Marrë në përgjithësi, kënaqshmëria e studentëve me stafin akademik për vitin 2020/2021 është 84% ose 4.2.

Tabela nr.2 Vlerësimi i stafit akademik

Pyetjet	Mesatarja
Syllabusi i lëndës, i cili përfshinë përmbajtjen dhe mënyren e vlerësimit, më është prezantuar në mënyrë të detajuar në fillim të semestrit	4.1574
Vijimi i mësimdhënësit gjatë semestrit ka qenë i rregullt dhe në kohë	4.2151
Mësimdhënësi ka ardhur gjithmonë i përgatitur në mësim	4.2447
Aktivitetet gjatë semestrit kanë krijuar mundësi që studentët të angazhohen në diskutime, aktivitete kreative, si dhe është inkurajuar ndërveprimi i studentëve (puna në grupe, dyshe, etj).	4.0607
Mësimdhënësi ka qenë në dispozicion të studentëve për konsultime, ne Universitet apo online	4.1385
Mësimdhënësi i inkurajon mendimet e ndryshme të studentëve dhe i respekton ato	4.1669

Materialet e ofruara për studime gjatë semestrit ishin të pershtatshme për fitimin e njohurive dhe të shkathtësive të parapara për këtë lëndë	4.1241
Materialet e ofruara nga mësimdhënësi janë publikuar me kohë në SMU, Teams apo në Moodle	4.1191
Studentët kanë qenë të informuar paraprakisht për kriteret e vlerësimit të provimit/punimeve ose të punës së tyre në përgjithësi	4.1945
Vlerësimi i punës së studentëve për lëndën gjatë semestrit është bërë sipas syllabusit të lëndës	4.1548
Nëse mësimi është mbajtur në klasë, mjetet e konkretizimit (markerat, projektori, tabela, etj) dhe hapësira e mësimi kanë qenë në dispozicion dhe janë shfrytëzuar mirë nga mesimdhënësi	4.0614
Mësimdhënësi ka përdorur platformën virtuale të mesimit Microsoft Teams dhe mundësitë e saj me lehtësi	4.2191
Lënda ka qenë e dobishme për studentët	4.2244